

DITËT E INFORMIMIT TË MATURANTËVE

Në kuadër të nismës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit si edhe me mbështetjen e Zyrës Vendore Arsimore Elbasan, Sektori i Këshillimit të Karrierës dhe Alumni-t, zhvilloi një sërë takimesh me shkollat e mesme publike dhe jopublike të Bashkisë Elbasan, në ambjentet e Universitetit “Aleksandër Xhuvani”.

Takimet me maturantët u shtrinë prej datës **22 shkurt deri në datë 6 mars** dhe u përfshinë gjithsej **23** shkolla të mesme.

Përfaqësues të stafeve akademike nga çdo fakultet, pjesë e Paneleve, promovuan Universitetin në përgjithësi, programet e studimit dhe facilitetet që UE ofron.





